



Në bazë të nenit 57, pika 2, nenit 108 pika 11 të Ligjit për Arsim të Lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/08, 103/08, 26/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11 dhe 15/13), nenit 144 të Statutit të Universitetit Shtetëror të Tetovës, Vendimit nga mbledhja e Këshillit të Rektoratit të datës 21.02.2013, në pajtim me Vendimin për organizimin e studimeve pasdiplomike në Universitetin Shtetëror të Tetovës dhe Rregulloren për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrimin e studentëve në studimet e ciklit të dytë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, si dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë së RM-së me numër 41-4052/1 të datës 16.06.2013, Universiteti shpall:

KONKURS

për regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në vitin akademik 2013/14

I. Numri i studentëve

Universiteti Shtetëror i Tetovës në studimet e ciklit të dytë, në afatin e dytë për vitin akademik 2013/14 do të regjistrojë 1452 studentë të rregullt dhe me korrespondencë.

I.a. Programe studimore njëvjeçare:

Fakulteti	Fusha shkencore	Grada shkencore	Numri i studentëve	Shuma e kofinansimit për semetër
	Studimet e magjistraturës			
Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore	Matematikë	Magjistër i matematikës		750
	- Matematikë e përgjithshme			
	Gjeografi	Magjistër i gjeografisë + emri i modulit	9 10	750
	- Gjeografi regjionale - Gjeografi socio-ekonomike			
	Informatikë	Magjistër i informatikës	18	750
	- Informatikë e përgjithshme			
	Biologji	Magjistër i biologjisë + emri i modulit	10 8 8	750
	- Botanikë			
	- Zoologji			
	- Biokimi			
	Kimi	Magjistër i kimisë + emri i modulit	9 10 10	750
	- Kimia organike me biokimi			
- Kimi analitike me mbrojtje të mjedisit jetësor - Kimi inorganike me kimi fizike				
Ekologji	Magjistër i ekologjisë	15	750	
Fizikë	Magjistër i fizikës	15	750	
Fakulteti Ekonomik	Ekonomi	Magjistër i ekonomisë + emri i modulit	39 37 30	750
	- Menaxhment – marketing			
	- Financa, kontabilitet dhe revizion			
	- Biznes-ekonomi	Magjistër i turizmit	20	750
Fakulteti Juridik	- E drejta penale	Magjistër i drejtësisë + emri i modulit	59	750
	- E drejta civile	Magjistër i së drejtës civile	25	
	-Marrëdhëniet ndërkombëtare (të drejtat e njeriut)	Magjistër i marrëdhënieve ndërkombëtare + emri i modulit	14 15	750
	Gazetari dhe medime*	Magjistër i gazetarisë Magjistër i medimeve	20 20	750
	Gazetari Medime			
Fakulteti Filozofik	Studime të magjistraturës			
	- Pedagogji	Magjistër i pedagogjisë	40	750
	- Filozofi	Magjistër i filozofisë	15	750
	- Sociologji	Magjistër i sociologjisë + emri i		750

	- Drejtimi kërkimor-shkencor	modulit	15	
	- Drejtimi arsimor		15	
	- Histori			
	- Historia bashkëkohore	Magjistër i historisë + emri i modulit	15	750
	- Historia e kohës së re		15	
	- Historia e mesjetës		15	
	-Psikologji			
- Psikologjia arsimore	Magjistër i psikologjisë + emri i modulit	14	750	
- Psikologji industriale		15		
Filologji orientale*				
Gjuhë dhe letërsi turke	Magjistër i gjuhës dhe letërsisë turke	15	750	
Gjuhë dhe letërsi arabe		Magjistër i gjuhës dhe letërsisë arabe		15
Fakulteti Filologjik	Gjuhë dhe letërsi shqipe			
	- Gjuhë shqipe	Magjistër i gjuhës shqipe	15	750
	- Letërsi shqipe	Magjistër i letërsisë shqipe	15	750
	Gjuhë dhe letërsi maqedonase			
	- Gjuhë maqedonase	Magjistër i gjuhës maqedonase	15	750
	- Letërsi maqedonase	Magjistër i letërsisë maqedonase	15	750
	Gjuhë dhe letërsi angleze			
	- Gjuhë angleze	Magjistër i gjuhës angleze	19	750
	- Letërsi angleze	Magjistër i letërsisë angleze	20	750
	Gjuhë dhe letërsi gjermane			750
	- Gjuhë gjermane	Magjistër i gjuhës gjermane	19	750
	Gjuhë dhe letërsi frënge			
	- Gjuhë frënge	Magjistër i gjuhës frënge	10	750
Fakulteti i Arteve	Arti muzikor			
	- Kompozim	Magjistër i artit muzikor + emri i modulit	5	1250
	- Dirigjim		5	
	- Muzikologji		5	
	- Etnomuzikologji		5	
	- Metodika e mësimt të muzikës		5	
	- Flauti		5	
	- Oboa		5	
	- Klarineti		5	
	- Fagoti		5	
	- Trompa		5	
	- Korn		5	
	- Tromboni		5	
	- Solo këndimi		5	
	- Piano		5	
	- Violina		5	
	- Viola		5	
- Violonçeli	5			
Arti figurativ				
- Pikturë	Magjistër i artit figurativ + emri i modulit	5	1250	
- Grafikë		4		
- Skulpturë		3		
- Dizajn grafik		7		
Art dramatik				
Akrim	Magjistër i artit dramatik+emri i modulit	5	1250	
Kamerë		5		
Regji filmi dhe Tv		5		
Fakulteti i Kulturës Fizike	Kulturë fizike			
	- Edukatë fizike dhe shëndetësore	Magjistër i kulturës fizike + emri i modulit	15	750
	- Sport		15	
	- Menaxhim i sportit		15	

I.b. Programe studimore njëvjeçare të specializimit:

Studime të specializimit	Metodika e mësimdhënies së mësimbesimit fetar	Profesor i metodikës së mësimdhënies së mësimbesimit fetar	20	/
	Studime specialistike në zhvillim rural*	Specialist i zhvillimit rural	30	750

I.c. Programe studimore dyvjeçare:

	Studime të magjistraturës				
Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit	- Teknologjia ushqimore	Magjistër i teknologjisë ushqimore	20	750	
	- Të ushqyerit	Magjistër i të ushqyerit	20	750	
Fakulteti Ekonomik	Ekonomi	Magjistër i ekonomisë + emri i modulit	38	500	
	- Menaxhment – marketing		47		
	- Financa, kontabilitet dhe revizion		30		
	- Biznes-ekonomi				
Fakulteti Juridik	Turizëm Menaxhmenti turistik	Magjistër i menaxhimit të turizmit	20	500	
	- Drejtimi gjyqësor - Drejtimi administrativ - E drejta ndërkombëtare dhe marrëdhëniet ndërkombëtare	Magjistër i drejtësisë + emri i modulit	47 28 30	500	
Fakulteti i shkencave mjekësore	Farmacit	Magjistër i farmacisë Magjistër i shkencave të farmacisë	20	750	
	Farmacit e përgjithshme Shkencat e farmacisë		15		
Fakulteti i shkencave të zbatuara	Ndërtimatri	Magjistër i ndërtimtarisë + emri i modulit	30	750	
	Ndërtimtari konstruktive Infrastrukturë dhe rrugë				
	Arkitekturë				
	Projektim Urbanizëm	Magjistër i arkitekturës + emri i modulit	27	750	
	Mekatronikë	Magjistër i mekatronikës	30	750	
	Ekonomi inxhinierike	Magjistër i ekonomisë inxhinierike	30	750	
Fakulteti i administratës së biznesit	Administratë biznesi	Magjistër i administratës së biznesit	30	500	
	Administratë publike	Magjistër i administratës publike	30	500	

*Programe në proces të akreditimit. Në këto programe regjistrimi i studentëve do të realizohet nëse për të njëjtat përfundon procedura e akreditimit.

Programi studimor Marrëdhënie ndërkombëtare (të drejtat e njeriut) ofrohet në bashkëpunim me Universitetin Shën Kirili dhe Metodij, Universitetin e Evropës Juglindore, Universitetin e Geteburgut dhe Akademinë Diplomatike të Vienës në korniza të Projektit Tempus 144787 “Studime ndëruniversitare të ciklit të dytë dhe të tretë në fushën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Maqedoni”. Ky program studimor do të zhvillohet vetëm në gjuhë angleze dhe kandidatët e përzgjedhur do t’i nënshtrohen intervistës së komisionit përkatës.

Në studimet specialistike në zhvillim rural, mësimi do të realizohet në gjuhën angleze. Kandidatët do të intervistohen nga komisioni përkatës.

II. Kushtet dhe kriteret për konkurrim

a). Të drejtë për konkurrim kanë kandidatët që i plotësojnë këto kushte të përgjithshme:

- Studimet e ciklit të dytë janë vazhdimësi e studimeve themelore.
- Në programet studimore të ciklit të II-të mund të regjistrohet personi i cili ka mbaruar programe studimore përkatëse të ciklit të parë dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet të cilat parashihen me Ligjin për Arsim të Lartë, Statutin e Universitetit dhe me këtë Rregullore si dhe në studime deridiplomike kanë arritur notën mesatare mbi 7.5 . Përcaktimi i notës mesatare, respektivisht pragu më i ulët i notës mesatare nuk vlen për studimet dyvjeçare të magjistraturës.
- Në ciklin e dytë të *studimeve universitare të specializimit profesional* me kohëzgjatje prej 1 (një) viti ose dy semestra, respektivisht 60 kredi, mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh, respektivisht 180 kredi.
- Kandidatët të cilët paraqiten për regjistrim në studimet specialistike në programin e Metodikën e Mësimdhënies së besimit fetar duhet që të kenë studimet e ciklit parë të përfunduar në institucion të arsimit të lartë të akredituar në

sferën e arsimimit të religjionit dhe përpos dokumenteve për aplikim duhet të dorëzojnë edhe **certifikatë** nga **MASH** i RM-së, për realizimin e seminarit për mësimin fetar në shkollat fillore.

- Në ciklin e dytë të **studimeve akademike universitare** me kohëzgjatje prej 2 (dy) vite ose katër semestra, respektivisht 120 kredi, mund të regjistrohen kandidatë të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh, respektivisht 180 kredi.
- Në ciklin e dytë të **studimeve akademike universitare** me kohëzgjatje prej 1 (një) viti ose dy semestra, respektivisht 60 kredi, mund të regjistrohen kandidatë të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh, respektivisht 240 kredi.
- Në ciklin e dytë të **studimeve akademike universitare** mund të regjistrohen edhe kandidatë të cilët kanë të kryer ndonjë program tjetër të ngjashëm pasi t'i ketë dhënë provimet diferenciale të Programit studimor në të cilin dëshiron të regjistrohet, me suksesin që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.
- Universiteti dhe njësitë e tij përcaktojnë se cilat studime janë të përshtatshme për regjistrim në programe të veçanta studimore të ciklit të II-të, si dhe kushtet për regjistrimin e kandidatëve të cilët kanë kryer programe të tjera studimore nga programi në të cilin aplikohet.
- Regjistrimi në program të ndryshëm nga programi në të cilin studenti ka diplomuar, **mund të bëhet me kusht që kandidati t'i ketë dëgjuar dhe t'i ketë dhënë provimet nga lëndët obligative** para komisionit prej 3 (tre) anëtarësh. Kryetari i komisionit duhet të jetë nga lëmia e ngushtë profesionale. Përcjellja e ligjëratave nga këta kandidatë bëhet gjatë vitit akademik, ndërsa provimeve duhet t'u nënshtrohen në afatin e qershorit.
- Kompatibiliteti i ciklit të parë të studimeve universitare për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve universitare, si dhe kushtet plotësuese për regjistrim në studimet e ciklit të dytë përcaktohen me aktin e njësisë akademike i cili i organizon studimet me propozim të programit studimor.

b). Shtetas të huaj

Shtetasit e huaj kanë të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit të II-të në mënyrë të njëjtë si edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë.

c). Procedura e seleksionimit

- Të drejtën e regjistrimit, në vitin e parë në studimet e ciklit të II-të, kandidati e fiton në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Konkurs sipas pikëve të fituara në procesin e seleksionimit.
- Në kushte të barabarta, **përparësi gjatë regjistrimit kanë kandidatët me notë më të lartë mesatare mbi 7,5** nga sukcesi i arritur gjatë studimeve, si dhe kohëzgjatje e përvojës së punës për kandidatët e paraqitur për studime me korrespondencë.
- Komisioni për Konkurs i njësisë, në tabelat e shpalljeve të fakultetit e shpall rangimin, nga rezultatet e arritura në ciklin e parë të studimeve universitare si dhe rezultatet nga kontrollimi i njohurive nga programet studimore në të cilat ai zbatohet.
- Pas shpalljes së ranglistës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs i njësisë, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24 orësh. Ankesën kandidati ia parashtron Komisionit të njësisë i cili e shpall Listën preliminare. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura.
- Komisioni ka për obligim të sjell Vendim në afat prej 24 orëve, nga momenti i skadimit të afatit për parashtrim të ankesave.
- Në rast se kandidati nuk është i kënaqur me vendimin e sjell nga ana e Komisionit të njësisë së Universitetit, në afat prej 24 orësh nga dita e shpalljes së vendimit të Komisionit, kandidati ka të drejtë të parashtrorjë ankesë deri te Komisioni Qendror. Vendimi i Komisionit Qendror universitar është përfundimtar.
- Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni Qendror universitar në fakultetin përkatës shpall Aktvendim për pranimin e studentëve (**Rang lista përfundimtare**), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ata të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit të Komisionit Qendror për pranim, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankimi.
- Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk e bëjnë regjistrimin, respektivisht nuk dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim (Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim) ose fare nuk paraqiten në shërbimet studentore në fakultetin në të cilin janë pranuar, do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga regjistrimi.
- Fakultetet të cilët edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit mbeten vende të paplotësuar, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë dhe të tretë regjistrues.

d). Studime të rregullta dhe me korrespondencë

- Studenti në studimet e ciklit të II-të mund të regjistrohet si student i rregullt dhe me korrespondencë.
- Programi i studimeve të rregullta u dedikohet studentëve që nuk janë të punësuar dhe kanë mundësi t'i ndjekin rregullisht mësimet.

- Njësitë akademike mund të organizojnë studime me korrespondencë nëse e lejon programi studimor dhe lënda studimore. Studentë me korrespondencë janë ata studentë të cilët programin studimor e ndjekin pjesërisht (përveç punës apo aktiviteteve tjera të cilat kanë nevojë për program specifik).
- Rregullat e studimit si dhe detyrimet e studentit me korrespondencë janë të njëjtë me ato të studentëve të rregullt (regjistrimi dhe vërtetimi i semestrit, vijimi në ligjërata, ushtrime, punë laboratorike, përgatitja e punimeve seminarike, puna praktike etj).
- Njësitë e Universitetit e përcaktojnë (me akreditim) formën e organizimit të aktiviteteve mësimore dhe vëllimin e ngarkesës në mësim për studentët me korrespondencë dhe studentët të cilët janë të kyçur në programin mësimor në distancë.
- Programi i studimeve me korrespondencë është i dedikuar për personat e punësuar, për shkak të detyrave të punës, ose për personat, të cilët për shkaqe të ndryshme nuk kanë mundësi t'i ndjekin mësimet e rregullta. Për shkak të karakterit të studimeve, kohëzgjatja e programit të studimeve me korrespondencë është më i gjatë se i studimeve të rregullta, por nuk duhet të jetë më i gjatë se dy vite akademike.
- Kohëzgjatjen e programit të studimeve me korrespondencë e përcakton bartësi i programit studimor të fakultetit përkatës, në varësi të mundësive të studentëve me korrespondencë për ndjekjen e mësimin.

III. Shpenzimet për studimet e rregullta dhe me korrespondencë në studimet e ciklit të II-të i mban vetë studenti me vetëfinancim të studimeve, sipas shumës së përcaktuar me pikën I të këtij konkursi, si taksë shkollimi. **Për punimin e temës së magjistraturës, studentët paguajnë 500 euro**, mjete të tjera plotësuese. Mjetet për punimin e magjistraturës, respektivisht specializimit, i paguajnë para mbrojtjes së punimit të magjistraturës, respektivisht të specializimit.

Në secilin program studimor 5% e studentëve në përputhje me ndryshimet e Ligjit për arsim të lartë të RM-së, në vitin akademik 2013/14, do të jenë të liruar nga pagesa e koefinancimit.

IV. Procesi mësimor

Mësimi në semestrin e parë të studimeve pasdiplomike do të fillojë më **19 Tetor dhe do të zgjasë deri më 30 Dhjetor të vitit 2013**, kurse semestri i dytë, nga **01 Shkurt deri më 01 Maj të vitit 2014**.

Këshilli i rektoratit do të sjell vendim për numrin minimal të studentëve të regjistruar me qëllim të fillimit të procesit mësimor në programin përkatës.

V. Afatet për paraqitje, kontrollimin i njohurive dhe aftësive dhe regjistrimi

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE – 2013/14	Afatet e regjistrimit
	Afati II
Aplikimi	1 deri 10 tetor 2013
Shpallja e rezultateve preliminare	14 tetor 2013
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	16 tetor 2013
Regjistrimi i kandidatëve	16 - 22 tetor 2013

VII. Dokumentet e nevojshme për paraqitje

Paraqitja bëhet në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Rruga e Ilindenit p.n. 1200 Tetovë.

Kandidati është i obliguar të parashtrijë fletëparaqitje për konkurrim në studimet e ciklit të II-të në afatin e përcaktuar të përcaktuar në pikën V, të këtij Konkursi.

Në fletëparaqitje kandidati duhet ta përcaktojë programin studimor në të cilën konkurren si dhe statusin e studimit: student i rregullt ose me korrespondencë (nëse me konkurs është përcaktuar mundësia e studimit me korrespondencë).

Krahas formularit për aplikim **kandidatët duhet të dorëzojnë:**

- Fletëparaqitje për aplikim;
- Diplomë për kryerjen e arsimit sipëror dhe Certifikatë për provimet e dhëna;
- Biografi të shkurtër (CV);
- Vërtetim për njohjen e së paku një gjuhe botërore, të dhënë nga institucioni arsimor adekuat.
- Rekomandime nga profesorë ose punonjës shkencorë (nëse i posedon ato);
- Vërtetim për përvojë në punë dhe për llojin e detyrave të cilat i ka ushtruar gjatë punës, si dhe kërkesë nga organizata e punës - institucioni, për regjistrim të studimeve pasdiplomike;
- Listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe kopje nga të njëjtat (nëse kandidatët kanë të tilla);
- Dëshmi për çmime të fituara, mirënjohje dhe të ngjashme, si dhe dokumente të tjera (nëse të tilla janë paraparë me aktet e institucionit përkatës).

- Vërtetim për pagesë të:
 - **1050 denarë** në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

Gjatë **regjistrimit**, kandidatët e pranuar duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studenti regjistrohet)
2. Tri fotografi (*dy* fotografi 6 x 9 dhe *një* – 4 x 5 c. m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
 - **1200 denarë**, në xhiro-llogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Indexit.
 - Pagesën e mjeteve për semestrin e parë

Të gjitha pagesat e lartpërmendura për **ciklin e dytë** do të kryhen në xhiro-llogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

- ❖ Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti Shtetëror i Tetovës,
- ❖ Në „banka e marrësit” (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë,
- ❖ Në „llogaria” (**сметка**) – 100000000063095,
- ❖ Në „shuma” (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhet,
- ❖ Në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues” (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**) – 1600160054 788 25;
- ❖ në „shifra dhe programi i të hyrave” (**приходна шифра и програма**) – 723012 43, ndërsa në „mënyra” (начин) – 2;
- ❖ Në „thirrja në numrin” (**повикување на број – задолжување**) shënohet numri i fakultetit në të cilin studion, në këtë mënyrë:
 - 723012 – 01: Fakulteti Ekonomik,
 - 723012 – 02: Fakulteti Juridik,
 - 723012 – 03: Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore,
 - 723012 – 04: Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë,
 - 723012 – 05: Fakulteti Filologjik,
 - 723012 – 06: Fakulteti Filozofik,
 - 723012 – 07: Fakulteti Shkencave të Zbatuara,
 - 723012 – 08: Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit,
 - 723012 – 09: Fakulteti i Kulturës Fizike,
 - 723012 – 10: Fakulteti i Arteve,
 - 723012 – 11: Fakulteti i Administratës së Biznesit.
- ❖ Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (**цел на дознака**) – qëllimi i pagesës (provim, semestri, certifikatë etj)

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit: http://www.unite.edu.mk
--

**Tetovë,
Shtator, 2013**